

LIGJI Nr. 04/L-156 PËR KONTROLLIN E DUHANIT

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR KONTROLLIN E DUHANIT

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Me synim të mbrojtjes së shëndetit publik, të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme nga pasojat shkatërruese shëndetësore, sociale, ekonomike dhe mjedisore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit, me këtë ligj përcaktohen masat për ndalimin, kufizimin e përdorimit të produkteve të duhanit, përbërësve të duhanit, parandalimin e pasojave të dëmshme nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe mbikëqyrjen për zbatimin e ligjit.

2. Për të arritur qëllimin e ligjit përcaktohen masa për të:

2.1. siguruar që të gjithë qytetarët janë të mbrojtur në mënyrë të barabartë dhe të efektshme nga ekspozimi i tymit të duhanit në hapësirat e mbyllura, të punës, hapësirat publike, hapësirat e hapura të veçanta dhe në mjetet e transportit publik,

2.2. parandaluar dhe reduktuar pirjen e duhanit me përcaktimin e normave që rregullojnë ambient pa tym të duhanit;

2.3. eliminuar nxitjet për pirjen e duhanit të cilat krijohen nga reklamimi, duke i ndaluar të gjitha reklamat, promovimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta;

2.4. informuar popullatën lidhur me rreziqet dhe dëmet specifike të përdorimit të produkteve të duhanit, pasojat e dëmshme shëndetësore, natyrën e varshmërisë, kërcënimet vdekjeprurëse që paraqet konsumimi i duhanit dhe ekspozimi ndaj tymit të duhanit;

2.5. këshilluar kundër përdorimit të duhanit dhe inkurajuar ndërprerjen e përdorimit të produkteve të duhanit nga përdoruesit;

2.6. ndaluar qasjen dhe blerjen e produkteve të duhanit për të miturit;

2.7. mbrojtur nga dëmet e shkaktuara nga përdorimi i produkteve të duhanit;

2.8. promovuar shëndetin dhe të drejtat e njeriut në përputhje me Konventën Kornizë për Kontroll të Duhanit të Organizatë Botërore të Shëndetësisë.

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Duhani** - bimë e familjes Nicotiniana të llojeve dhe tipeve të ndryshme të modifikuar apo jo të modifikuar gjenetikiisht, me gjithë pjesët e saj.

1.2. **Produkt i duhanit** - produktet e duhanit (të modifikuara apo të pamodifikuara gjenetikiisht) apo pjesërisht nga duhani, që përdoren për t'u pirë, tërhequr me hundë, thithje, përtypje, apo të çdo lloji tjetër të konsumimit.

1.3. **Kontroll i duhanit** - masat për zvogëlimin të kërkesës dhe të dëmit, me qëllim të përmirësimit të shëndetit të popullatës duke eliminuar ose reduktuar përdorimin e prodhimeve të duhanit dhe ekspozimin ndaj tymit të duhanit”.

1.4. **Katrani** - mbetje e thatë e tymit të duhanit pa nikotinë.

1.5. **Nikotina** - alkaloid helmues i cili gjendet në duhan dhe ka veprim helmues në sistemin nervor autonom, dhe në sistemet tjera të organizmit.

1.6. **Përbërësi** - çdo lloj substance apo elementi, përveç çfarëdo pjese të bimës së duhanit natyral të pa procesuar që përdoret në prodhimin e produkteve të duhanit e që është i pranishëm në produktin final edhe në qoftë se është në formë të ndryshuar duke përfshirë këtu edhe letrën, filtrin, ngjyrat dhe ngjitësin.

1.7. **Pirja e duhanit** - përdorimi i produkteve të duhanit pa marrë parasysh se tymi i cigares i lëshuar me djegien e saj thithet në mënyrë aktive apo pasive, e që ka si pasojë dëmtimet e vërtetuara të shëndetit të duhanpirësve aktiv dhe pasiv të cilët janë të ekspozuar ndaj tymit të duhanit.

1.8. **Masat parandaluese kundër pirjes së duhanit** - veprimet të cilat kanë për qëllim përparimin, ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit, si dhe ngritjen e cilësisë të jetës së qytetarëve.

1.9. **Hapësirë e mbyllur** - çdo hapësirë e mbuluar me kulm ose tavan, që është i lëvizshëm apo i palëvizshëm, dhe të rrethuar me dy apo më shumë anë, pa marrë parasysh llojin e materialit të përdorur dhe pa marrë parasysh nëse struktura është e përhershme apo e përkohshme.

1.10. **Hapësirë e hapur** - çdo hapësirë publike që nuk është e mbyllur.

1.11. **Hapësirë publike** - hapësirë e mbyllur e cila i dedikohet qëndrimit të dy apo më shumë njerëzve dhe përfshin hapësirat në të cilat kryhen aktivitetet nga lëmi i shëndetësisë, sociale, edukative, arsimore, sportive dhe rekreative, kulturore, artistike, lokaleve hoteliere e shërbyese, hapësirave për pritje, mbledhje e takime, vende të punës me pronësi publike ose private, të gjitha sallat për tubimin e njerëzve dhe mjetet e transportit publik.

1.12. **Hapësirë e punës** - çdo vend të përdorur nga një apo më shumë persona gjatë punës, pa marrë parasysh se a bëhet me kompensim apo vullnetar, dhe përfshin të gjitha hapësirat e bashkangjitura apo të ndërlidhura që zakonisht përdoren gjatë procesit të punës apo kohë pas kohe.

1.13. **Vend publik** - vendi ku secili person ka qasje të lirë si rruga, tregu, parku dhe të

ngjashme.

1.14. **Mjetet e transportit** - çdo mjet transporti publik dhe privat të përdorur për bartjen e qytetarëve.

1.15. **ISO** - Organizata Ndërkombëtare për Standardizim ISO është rrjet i institucioneve kombëtare standardizuese.

1.16. **Konflikt interesi** - konflikt në mes të detyrave zyrtare dhe interesave private të mbajtësit të postit publik, apo kandidatit për post publik, që ka përgjegjësi për kontroll të duhanit, e që mund të lidhet me interesat e tij, dhe të familjarëve të tij.

1.17. **Vërejtjet dhe porositë për shëndetin** - teksti i shkruar dhe fotografitë përcjellëse me ngjyra të kërkuara nga ministria që të vendosen në paketimet dhe shenjzimet e duhanit që bartin pasojat shëndetësore dhe ato të tjera të përdorimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit, si dhe çdo porosi tjetër e shkruar.

1.18. **Ministër** -Ministri i Shëndetësisë.

1.19. **Ministria** - Ministria e Shëndetësisë.

1.20. **Qeveria** – Qeveria e Republikës së Kosovës.

1.21. **Paketimi dhe shenjzimi i jashtëm lidhur me prodhimet e duhanit** - paketimi dhe shenjzimin i përdorur në prodhimet e shitjes me pakicë.

1.22. **Person** - çdo person fizik, juridik dhe të gjitha subjektet afariste.

1.23. **Personi përgjegjës për hapësirat** - udhëheqësi, pronari, menaxheri, apo personi tjetër përgjegjës për hapësirën e mbyllur, të hapur, publike, hapësirën e punës, apo mjetet e transportit publik.

1.24. **Mbajtës i postit publik** - person zyrtar, përfaqësues zyrtar, këshilltar, inspektor, zyrtar policor, zyrtar doganor, apo nëpunës qeveritar i zgjedhur në nivel qendror a lokal të qeverisjes.

1.25. **Shitës** - çdo person që shet me pakicë, shumicë, eksporton dhe importon prodhime të duhanit dhe produkteve të tij.

1.26. **Reklamat dhe promovimet e duhanit** - çdo aktiviteti me qëllim, efekt, apo efekt të pritshëm të promovimit të prodhimeve të duhanit apo përdorimit të duhanit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte.

1.27. **Sponsorimi direkt apo indirekt** - çdo formë të kontributit në ndonjë ngjarjeje, aktiviteti, organizate, apo individi që ka qëllimin, efektin, apo efektin e mundshëm të promovimit të ndonjë produkti të duhanit, dhe përdorimin e duhanit.

1.28. **Industria e duhanit** - prodhuesit, shitësit me shumicë dhe importuesit.

1.29. **Gjobat mandatore** - të gjitha gjobat që organet mbikëqyrëse i zbatojnë aty për aty.

KREU II RREGULLIMI, TESTIMI DHE RAPORTIMI I PRODUKTEVE TË DUHANIT

Neni 3 Rregullimi i produkteve të duhanit

1. Ndalohet prodhimi dhe qarkullimi i cigareve të cilat përmbajnë përbërës me këto vlera:
 - 1.1. më shumë se dhjetë (10mg) katran për një cigare,
 - 1.2. më shumë se një (1mg) miligram nikotinë për një cigare,
 - 1.3. më shumë se dhjetë (10mg) monoksid të karbonit për një cigare.
2. Asnjë person nuk lejohet të prodhojë apo shesë produkte të duhanit që nuk i plotësojnë vlerat dhe standardet e produktit të përcaktuara sipas këtij ligji.
3. Produktet e duhanit të importuara duhet të plotësojnë standardet e përcaktuara sipas paragrafit 1. të këtij neni, përveç cigareve puro, duhanit të llullës dhe duhanit të grirë për mbështjellje.
4. Produktet e duhanit që gjenden në posedim ose nën kontroll të ndonjë prodhuesi apo shitësi të duhanit, ose i dedikuar për treg, që nuk i përmbushin standardet duhet të shkatërrohen, duke i bartur të gjitha shpenzimet vet subjekti, përfshirë edhe dënimin me gjobë.

Neni 4 Testimi i produkteve të duhanit

1. Ministria, mbështetur në të dhënat shkencore, mban të drejtën të ndalojë përdorimin e përbërësve të ndryshëm në prodhimet e duhanit.
2. Të gjitha produktet e duhanit që prodhohen apo importohen për tregun e Kosovës duhet të testohen.
3. Testimet për katranin, nikotinën dhe monoksidin e karbonit për cigare bëhen në laboratorët e licencuar apo autorizuar nga Ministria së paku njëherë në vit.
4. Ministria mban të drejtën të kërkojë nga prodhuesit apo importuesit e duhanit teste shtesë për të përcaktuar dhe vlerësuar prezencën dhe përqendrimin e substancave tjera që nuk janë përfshirë në paragrafin 3 të këtij neni.
5. Testimet për substancat e përfshira në paragrafin 3. duhet të bëhen me standardet e përcaktuara nga Ministria përmes zbatimit të standardeve ISO. Duhet të përdoren këto standarde: ISO standardi 4387 për katranin, 10315 për nikotinën dhe 8454 për monoksidin e karbonit. Saktësia e paraqitjes të sasisë së katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit në paketim verifikohet përmes ISO standardit 8243.
6. Testimet dhe rezultatet e tyre dorëzohen në afat kohor që përcakton Ministria.
7. Prodhuesi apo importuesi i prodhimeve të duhanit duhet t'i paraqesë Ministrisë çdo ndryshim të përbërjes kimike të prodhimeve të duhanit.
8. Në qoftë se përbërja e mostrës së marrë nga një seri e prodhimeve të duhanit, dëshmohet nga laboratorit i licencuar se nuk u përmbahet vlerave të parapara me ligj, atëherë ajo seri tërhiqet nga

tregu.

9. Ministria do të mbikëqyrë rregullshmërinë dhe saktësinë e të dhënave të përbërësve të produkteve të duhanit që prodhohen apo importohen dhe shiten në tregun e Kosovës.

10. Kërkesën për testim shtesë sipas paragrafit 3. të këtij neni mund ta iniciojë Inspektorati Sanitar.

Neni 5

Raportimi i përmbajtjes dhe emitimit të produkteve të duhanit

1. Prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit duhet t'i paraqesin Ministrisë listën e të gjithë përbërësve dhe sasive të tyre që përdoren gjatë prodhimit të produkteve të duhanit një herë në vit, në tremujorin e parë të vitit.

2. Lista duhet të përmbajë arsyetimin për përfshirjen e përbërësve në produktet e duhanit, dhe kategorinë e përbërësve.

3. Listës duhet t'i bashkëngjiten të dhënat toksikologjike nga prodhuesi apo importuesi për përbërësit e produkteve të duhanit, duke u referuar në efektet e tyre në shëndet dhe vetitë për të shkaktuar varshmëri.

4. Përbërësit e duhanit duhet të radhiten në listë sipas peshës së tyre.

KREU III

PAKETIMI DHE SHENJËZIMI I PRODHIMEVE TË DUHANIT

Neni 6

Vërejtjet dhe shenjëzimet në paketimet e produkteve të duhanit

1. Produktet e duhanit që shiten në tregun e Kosovës duhet të kenë shenjëzime në pajtueshmëri me dispozitat e parapara me këtë ligj dhe të kenë informata për pasojat negative për shëndetin e njeriut nga përdorimi i duhanit në harmoni me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

2. Çdo lloj paketimi individual i produkteve të duhanit që prodhohet, importohet dhe qarkullon e shitet në tregun e territorit të Kosovës duhet të përmbajë këto të dhëna:

2.1. Nikotina,

2.2. Katrani,

2.3. monoksidi i karbonit,

2.4. numrin serik apo ekuivalent të tij,

2.5. emrin dhe adresën e prodhuesit dhe importuesit,

2.6. numrin e njërive në paketime individuale të produkteve të duhanit.

2.7. emri dhe adresa e paketuesit, në raste kur prodhuesi nuk e ka bërë paketimin vetë.

3. Çdo njësi e paketimit të produkteve të duhanit duhet të ketë këto vërejtje:

3.1. së paku njëërën nga vërejtjet e përgjithshme:

3.1.1. "Pirja e duhanit vret" ose

3.1.2. "Pirja e duhanit shkakton vdekje të parakohshme"

3.2. së paku njëërën nga vërejtjet shtesë:

3.2.1. "Duhani dëmton shëndetin tuaj"

3.2.2. "Pirja e duhanit shkakton kancerin"

3.2.3. "Pirja e duhanit nga shtatzënat e dëmton zhvillimin e fëmijës"

3.2.4. "Pirja e duhanit shkakton infarkt dhe sulm në tru"

3.2.5. "Pirja e duhanit shkurton jetën e juaj"

3.2.6. "T'i mbrojmë fëmijët: mos lejoni ta thithin tymin e cigares tuaj"

3.2.7. "Duhani shkakton plakjen e lëkurës"

3.2.8. "Pirja e duhanit është sëmundje e varësisë"

3.2.9. "Duhanpirësit vdesin të rinj"

3.2.10. "Mjeku juaj mund të ju ndihmojë që të lini pirjen e duhanit"

3.2.11. "Pirja e duhanit shkurton jetën"

3.3. vërejtjet e kombinuara:

3.3.1. fotografia ose ilustrimi tjetër dhe teksti korrespondues i vërejtjes shtesë.

4. Vërejtja e përgjithshme dhe ajo shtesë duhet të paraqiten në atë mënyrë që gjatë rrotullimit të paketimit, vërejtjet të paraqiten vazhdimisht dhe në formë të rregullt.

5. Vërejtja e përgjithshme shtypet në faqen ballore, kryesore të njësisë së paketimit të produkteve të duhanit dhe duhet të përfshijë tridhjetë e dy për qind (32%) të kësaj sipërfaqeje të dukshme përveç mbështjellësve të tejdukshëm.

6. Vërejtja shtesë shtypet në sipërfaqen tjetër më të dukshme, e pasme të njësisë së paketimit të produkteve të duhanit dhe duhet të përfshijë dyzet e pesë për qind (45%) të kësaj sipërfaqeje përveç mbështjellësve të tejdukshëm.

7. Vërejtja e kombinuar mbulon dyzet e pesë për qind (45%) të sipërfaqes së pasme të njësisë së paketimit të produkteve të duhanit.

8. Teksti mbi vërejtjet e përgjithshme, shtese dhe të kombinuara kufizohet me një vijë në trashësi dy (2) deri në tre (3) milimetra.

9. Teksti mbi të dhënat për nikotinën, katranin dhe monoksidin e karbonit dhe teksti i vërejtjeve duhet të:

9.1. shtypet me fontin e zi Helvetik, të theksuar, të trashë në sfond të bardhë. Madhësia e fontit duhet të jetë e tillë që teksti të mbulojë pjesën më të madhe të sipërfaqes së paraparë për

vërejtjen;

9.2. të jetë me shkronja të vogla përveç shkronjës së parë dhe duke respektuar rregullat e drejtshkrimit;

9.3. të vendoset në mënyrë qendrore paralelisht në skajin e sipërm të paketimit;

9.4. teksti kufizohet me një vijë me trashësi tre (3) deri në katër (4) milimetra e që nuk takon apo gërsheton tekstin e vërejtjes apo të informatave tjera;

9.5. teksti duhet të jetë në gjuhë/t zyrtare.

10. Shtypja e tekstit të vërejtjes nuk lejohet të bëhet në banderolën taksative të paketimit.

11. Teksti i shtypur duhet të jetë i pashlyeshëm dhe që nuk mund të hiqet pa u dëmtuar teksti, dhe në asnjë mënyrë të jetë i fshehur me shtypje tjera në njësi të paketimit apo të hiqet ose dëmtohet gjatë hapjes së paketimit.

12. Paketimi duhet të shënohet me numër serik apo metodë tjetër të përshtatshme që bën të mundshëm përcaktimin e lehtë të vendit dhe kohës së prodhimit të duhanit.

13. Çdo njësi e paketimeve të produkteve të duhanit duhet të ketë fotografi që dekurajojnë përdorimin e produkteve të duhanit të përcaktuar me akt nënligjor nga Ministria.

14. Vërejtjet, fotografitë dhe porositë e përshkruara të shëndetit duhet të jenë vazhdimisht të paraqitura në secilën pjesë të paraqitjes të gjitha njësitë të produkteve të duhanit dhe jashtë kutisë dhe shenjzimeve.

15. Vërejtjet, fotografitë ose ilustrimet me ngjyra dhe porositë për efektet e dëmshme të duhanit në shëndet duhet të jenë të paraqitura në intervale kohore me rotacion, në atë mënyrë që të sigurojë shfaqje të rregullt të gjitha vërejtjeve shtesë.

16. Hapja normale e pakos nuk duhet të dëmtojë, mbulojë, ndërpresë, ose ndryshe të pengojë dukshmërinë e vërejtjeve dhe porositve. Vërejtjet dhe porosit nuk duhet të jen të mbuluara nga ndonjë shenjzim, vulë, apo ndonjë dizajn tjetër.

17. Pakot e produkteve të duhanit në shitje me pakicë nuk duhet të përmbajnë ndonjë material të dizajnuar, që ndryshojnë paketimin pas shitjes me pakicë, duke përfshirë, por duke mos përjashtuar:

17.1. lidhje të aktivizuara me ngrohje;

17.2. ngjyra apo vija të dizajnuara për t'u paraqitur pas një kohe të caktuar;

17.3. ngjyra që kanë paraqitje fluoreshente nën drita të caktuara;

17.4. pjesë të dizajnuara për t'u gërvishtur ose fërkuar për të zbuluar ndonjë tekst apo fotografi;

17.5. pjesë të ngjitura;

17.6. pjesë që palosen.

18. Ministria mban të drejtën të ndryshojë apo shtojë vërejtjet e përgjithshme, shtesë dhe ato të kombinuara.

19. Ministria do të përcaktojë vërejtjet e kombinuara me akt nënligjor.

Neni 7

Ndalimi i mashtrimeve në paketim, shenjzim dhe dizajn të produktit

Njësia, paketimi, shenjzimi i jashtëm dhe dizajni apo dukja e produkteve të duhanit nuk duhet të promovojnë produktet në asnjë mënyrë që japin informata jo adekuate, mashtruese, apo mund të krijojnë përshtypje të gabuar lidhur me karakteristikat e prodhimit, ndikimet në shëndet, rreziqet apo emisionet e produkteve të duhanit. Këtu përfshihet përdorimi i çfarëdo termi, përshkruesi, shenje, figure, ngjyre, apo ndonjë shenje tjetër që drejtpërdrejt apo indirekt krijon, apo mund të krijojë përshtypjen e gabuar, se një produkt i caktuar i duhanit është më pak i dëmshëm se të tjerët, si p.sh. “butë”, “lehtë”, “ekstra i lehtë”, “ekstra”, “ultra” dhe terme tjera në çfarëdo gjuhe, që mund të hutojnë konsumatorët, përfshirë edhe kur përdoren si pjesë e emrit të tipit dhe llojit.

KREU IV

NDALIMI I REKLAMAVE, PROMOVIMIT DHE SPONZORIMIT TË PRODUKTEVE TË DUHANIT

Neni 8

Ndalimi i reklamimit, promovimit dhe sponsorimit të produkteve të duhanit

1. Ndalohen të gjitha reklamat, promovimet, sponsorimet vendore dhe ndërkufitare të ngjarjeve ose aktiviteteve dhe asnjë person, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nuk lejohet të:

1.1. nxisë asnjë formë të reklamimit, promovimit dhe sponsorimit;

1.2. prodhojë, publikojë, apo të ofrojë qasje në çfarëdo reklame, promovimi, ose sponsorimi;

1.3. përfshihet apo të marrë pjesë në ndonjë reklamë, promovim, ose sponsorim si media apo organizator i ngjarjeve, person i famshëm apo pjesëmarrës tjetër, si pranues i çfarëdo kontributi sponsorues, ose si ndërmjetës që lehtëson ndonjë kontribut të tillë duke përfshirë edhe çdo komunikim komercial, veprim apo praktikë që promovon apo mund të promovojë ndonjë prodhues të duhanit, shitës me shumicë, ose importues drejtpërdrejt apo indirekt.

2. Ndalohen të gjitha reklamat, promovimet dhe sponsorimet e duhanit të sponsoruara dhe të iniciuara nga ndonjë shtetas i huaj apo vendi në territorin e Republikës së Kosovës.

3. Ndalohet reklamimi i produkteve të cilat sipas këtij ligji nuk janë produkte të duhanit por me dukjen e tyre, emërtimin dhe qëllimin e përdorimit, nxisin përdorimin e produkteve të duhanit.

4. Ndalohet dhurimi i produkteve të duhanit nga subjektet që i prodhojnë, i importojnë dhe i tregtojnë ato.

5. Ndalohet sponsorimi i programeve në mediat e shkruara dhe elektronike, ngjarjeve apo aktiviteteve nga prodhuesit apo importuesit e produkteve të duhanit me qëllim të nxitjes së fshehtë apo të hapur të përdorimit të produkteve të duhanit.

6. Reklamimi në pajtim me këtë nen nuk përfshin këto njoftime:

6.1. për çmimet e fituara dhe njohjeve tjera publike për cilësinë e disa produkteve, sukseset e punës, sukseset prodhuese dhe të tjera, që janë arritur gjatë prodhimit të produkteve të duhanit, por pa emërtimin e cituar të produktit nga prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit nëpërmjet mediave;

6.2. gjatë mbajtjes së panairove të specializuara dhe ekspozitave në hapësirën e panairit ose ekspozitës, kohës së ekspozimit të produkteve të reja, e cila organizohet në hapësirë të mbyllur;

6.3. për cilësinë dhe karakteristikat tjera të produkteve të duhanit të publikuara në librat profesional, revistat dhe botimet tjera profesionale që janë të destinuara veçmas për prodhuesit dhe importuesit e këtyre produkteve;

6.4. për karakteristikat tjera të produkteve të duhanit që konsumatorët mund të marrin në objektet ku bëhet shitja e produkteve të duhanit, në pajtim me ligjin.

KREU V SHITJA E PRODUKTEVE TË DUHANIT

Neni 9 Kufizimi i shitjes së produkteve të duhanit

1. Shitja apo ofrimi i produkteve të duhanit ndalohet në:

1.1. të gjitha institucionet shëndetësore, përfshirë edhe oborrin në administrim të institucionit;

1.2. të gjitha institucionet edukative dhe arsimore, përfshirë edhe oborrin në administrim të institucionit;

1.3. të gjitha llojet e objekteve sportive, rekreative dhe kulturore, përfshirë edhe oborrin në administrim të institucionit.

2. Produktet e duhanit nuk lejohen të vendosen apo të jenë të dukshme në asnjë vend të shitjes, përveç se të jenë të dukshme në momentin e transaksionit të shitjes, dhe nuk duhet të jenë të shfaqur për qëllime komerciale në asnjë vend tjetër.

3. Nuk lejohet të vendosen produktet e duhanit në vende ku konsumatori mundet vetë të shërbehet me duhan.

4. Shitja e duhanit përmes aparateve të shitjes lejohet vetëm në hapësirat e mbyllura të objekteve hoteliere, që i plotësojnë kushtet sipas këtij ligji.

5. Asnjë person nuk lejohet të shesë prodhime të duhanit jashtë paketimit origjinal të prodhuesit apo importuesit.

6. Produktet e duhanit mund të shiten vetëm në pako të mbyllura.

Neni 10 Parandalimi i qasjes së të miturve në produkte të duhanit

1. Asnjë person nuk lejohet t'u shesë të miturve produkte të duhanit.

2. Asnjë person i mitur nuk lejohet të shes produkte të duhanit.

3. Asnjë person nuk lejohet, të punësojë një të mitur për të shitur produkte të duhanit.

4. Shitësit e produkteve të duhanit me pakicë detyrohen të paraqesin në vendet e tyre të shitjes shenjat për ndalimin e shitjes së produkteve të duhanit personave më të rinj se tetëmbëdhjetë (18) vjeç.

5. Asnjë personi nuk i lejohet shitja:

5.1. ëmbëlsirave, lodrave dhe produkteve tjera të dedikuara për fëmijë, të cilat kanë formë të çfarëdo lloji të prodhimeve të duhanit.

5.2. prodhimet që nuk janë produkte të duhanit, por e kanë emrin e prodhuesit të duhanit, apo emërtimin e çfarëdo lloji të produkteve të duhanit apo shenjës dalluese, logos, apo shenjave të ngjashme, të cilat ngjajnë në produkte të duhanit.

6. Ministria mund të ndër marrë masa shtesë lidhur me shitjen e produkteve të duhanit për të evituar qasjen e të rinjve në produktet e duhanit.

KREU VI MJEDISËT PA TYM DUHANI

Neni 11 Mbrojtja nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit

1. Ndalohet pirja e duhanit në:

1.1. hapësirë publike;

1.2. hapësirë të punës;

1.3. mjetet e transportit publik;

1.4. hapësirat e hapura të përcaktuara në paragrafin 3. të këtij neni.

2. Në ndërtesat me banesa shumëkatëshe, asnjë person nuk lejohet të pijë duhan në ndonjë hapësirë të përbashkët të ndërtesës.

3. Asnjë person nuk lejohet të pijë duhan në ndonjë hapësirë të hapur që është:

3.1. në administrim të institucioneve edukative-arsimore;

3.2. në afërsi të hyrjeve/daljeve të hapësirave publike, hyrjeve/daljeve të hapësirës së punës dhe në hyrjeve/daljeve të institucioneve shëndetësore

3.3. vendet e lojërave për fëmijë;

3.4. stadium, arenë, apo hapësirë për çfarëdo shfaqje.

4. Ndalesat e pirjes së duhanit të përcaktuara në këtë nen do të aplikohen edhe në përdorimin e ndonjë pajisje që prodhon emisione të nikotinës apo ndonjë substance tjetër që rrjedh nga duhani, përveç nëse ajo pajisje është lejuar për përdorim nga ministria si terapi për zëvendësimin e nikotinës apo për qëllime tjera mjekësore.

5. Me përjashtim të paragrafit 1., 2., dhe 3. të këtij neni, pirja e duhanit lejohet vetëm në hapësirat e dedikuara për pirjen e duhanit në institucionet ku trajtohen personat e palëvizshëm, personat me

çrregullime mendore, ku strehohen personat e moshuar, dhe në institucionet korrektuese. Lejimi vlen për personat që trajtohen dhe/apo mbahen në këto institucione.

6. Me përjashtim të paragrafit 1., 2., dhe 3., personi përgjegjës i hotelit ka të drejtë të dedikoj dhoma të veçanta për mysafirë që përdorin duhanin.

7. Ministria me akt nënligjor do të përcaktojë kushtet në hapësirën për pirjen e duhanit, për institucionet sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni.

8. Çdo çështje që mund të ngrihet nëse pirja e duhanit është e lejuar në ndonjë situatë të caktuar duhet të zgjidhet në favor të mbrojtjes së të gjithë punëtorëve dhe anëtarëve të publikut, me krijimin e një ambienti të lirë nga tymi i duhanit.

Neni 12 **Detyrat e personit përgjegjës për hapësirën**

1. Personat përgjegjës për hapësirat e specifikuar në nenin 11., paragrafi 1., 3., 5. dhe 6. kanë detyrë të:

1.1. vendosin shenjat “ndalohet pirja e duhanit dhe vlera e dënimit” në bazë të formatit, përmbajtjes, dizajnit, madhësisë, dukshmërisë, vendit dhe të gjitha materialet e tjera të përcaktuara me akt nënligjor nga ministria;

1.2. largojnë të gjitha taketuket nga hapësirat e mbyllura ku ndalohet pirja e duhanit.

1.3. mbikëqyrin respektimin e ndalimit të pirjes së duhanit;

1.4. ndërmarrin hapa për të ndaluar personin nga pirja e duhanit në vendet ku është i ndaluar, duke kërkuar nga personi që të mos pijë duhan, të mos i ofrojnë shërbim, të kërkojnë që personi të largohet nga lokalet apo transporti publik kur është e sigurt që kjo të bëhet, dhe të kontaktojnë organet përkatëse për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit;

1.5. organi i punësimit i zbrit nga paga neto mujore prej pesëdhjetë (50) euro personit fizik që pi duhan në vend të punës në bazë të raportimit paraprak të personit përgjegjës.

KREU VII **PARANDALIMI, VETËDIJESIMI DHE EDUKIMI**

Neni 13 **Masat parandaluese**

1. Qeveria e Kosovës formon Këshillin ndërministror për kontroll të duhanit me qëllim të mbrojtjes së shëndetit.

2. Këshilli do të ketë pesëmbëdhjetë (15) anëtarë ku do të përfshihen: përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë; Arsimit, Shkencës e Teknologjisë; Financave; Punës dhe Mirëqenies Sociale; Drejtësisë; Punëve të Brendshme; Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Infrastrukturës; Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Kulturës, Rinisë e Sporteve; profesionistë shëndetësor, përfaqësues të mjeteve të informimit dhe shoqëria civile.

3. Kryesues i Këshillit ndërministror për kontrollin e duhanit është Ministri i Shëndetësisë.

4. Masat për vetëdijesimin dhe edukimin:

4.1. Radio Televizioni Publik i Kosovës, duhet të emitoj programe edukative, për të shpjeguar efektet e dëmshme të konsumit të duhanit, pa ndonjë kompensim financiar, për secilin muaj së paku dyzet e pesë (45) minuta. Këto programe duhet të emitohen nga ora 08:00 deri në ora 22:00. Një kopje e programit duhet të publikohet në faqen e emetuesit dhe mediave përkatëse. Emetimi i programeve dhe kohëzgjatjes duhet të monitorohet nga Këshilli ndërmnistror.

4.2. Radio Televizionet private, të emitojnë programi edukative për të shpjeguar efektet e dëmshme të duhanit.

4.3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, do të përgatis kurrikulën, për të njoftuar dhe paralajmëruar fëmijët dhe të rinjtë për dëmet shëndetësore të produkteve të duhanit dhe ekspozimit ndaj duhanit.

4.4. Ministria obligohet të ndërmarrë aktivitetet e nevojshme me qëllim të përpilimit të programeve që inkurajon individin të ndërpresë përdorimin e produkteve të duhanit.

KREU VIII MBROJTJA E POLITIKAVE TË KONTROLLIT TË DUHANIT NGA INTERESAT KOMERCIALE DHE INTERESAT E TJERA TË INDUSTRISE SË DUHANIT

Neni 14

Kufizimet e ndërveprimit në mes të qeverisë dhe industrisë së duhanit

1. Ndërveprimet në mes të qeverisë dhe industrisë së duhanit duhet të jenë të kufizuara vetëm në ato të nevojshme për rregullimin efektiv të industrisë së duhanit apo prodhimeve të duhanit.
2. Kur ndonjë ndërveprim ose kontakt në mes të qeverisë dhe industrisë së duhanit është i nevojshëm për rregullim efektiv, qeveria duhet të sigurojë transparencë të plotë.

Neni 15

Ndalimi i partneriteteve të qeverisë dhe aprovimi apo pranimi i iniciativave të industrisë së duhanit

1. Qeveria nuk duhet të marrë pjesë në, të përkrahë, të adaptojë, ose të pranojë:
 - 1.1. partneritete të asnjë lloji me industrinë e duhanit, përfshirë iniciativat apo aktivitetet e industrisë së duhanit të përshkuara, karakterizuara, të kuptuara, apo që mund të jenë të perceptuara si përgjegjësi sociale;
 - 1.2. ndonjë marrëveshje jo obliguese, ose jo të aplikueshme, memorandum të mirëkuptimit, aranzhim vullnetar, ose ndonjë kod të mirësjelljes së industrisë së duhanit në vend të masave legalisht të aplikueshme të kontrollit të duhanit;
 - 1.3. ndonjë kontribut financiar ose burimor të drejtpërdrejtë ose indirekt, ose përfshirje në çfarëdo mënyre në ndonjë initiative, fushatë, ose program drejtpërdrejtë apo tërthortë të lidhur me kontrollin e duhanit apo shëndetin publik, duke përfshirë, por duke mos përjashtuar, qasjen e të rinjve dhe programet edukative, fushata për edukimin e publikut, dhe iniciativa tjera.

Neni 16
Ndalimi i kontributeve vullnetare nga industria e duhanit

1. Ndalohet që Qeveria të pranojë ndonjë kontribut vullnetar të çfarëdo lloji, financiar apo tjetër, vetëm nëse ai kontribut vjen si rezultat i ndonjë veprimi ligjor.
2. Ndalohet pranimi i ndonjë kontributi vullnetar financiar apo kontribut tjetër të çfarëdo lloji, përfshirë edhe ndonjë dhuratë apo privilegj nga mbajtësi i postit publik.
3. Ndalohet që partia politike, kandidati, ose përmes fushatës, ose ndonjë personi që vepron në emër të tyre të pranojë ndonjë kontribut vullnetar financiar apo kontribut tjetër të çfarëdo lloji.
4. Dispozitat e këtij neni do të vlejnjë edhe për shitësit me pakicë të duhanit kur ofertat, kontributet, apo veprimet tjera bëhen me qëllim, apo mund të kenë ndikim, apo ndikim të mundshëm në shtytjen e interesave të biznesit të tij të duhanit.

Neni 17
Papajtueshmëria

1. Qeveria nuk duhet të punësojë, kontrakttojë, apo të angazhojë ndonjë person për të kryer punë ose shërbyer në çfarëdo kapaciteti me përgjegjësi për kontrollin e duhanit, nëse ai person është i angazhuar profesionalisht me industrinë e duhanit, ose ka punuar aty në dymbëdhjetë (12) muajt e kaluar, ose nëse ai person ka ndonjë konflikt tjetër të interesit me përgjegjësitë e pozitës, kontratës, ose shërbimit për kontrollin e duhanit.
2. Zyrtari i lartë i cili përfundon ushtrimin e funksionit publik nuk ka të drejtë për një vit të punësohet ose të emërohet në pozitë udhëheqëse, apo të përfshihet në kontrollin e kompanive të duhanit, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy (2) vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen apo kontrollin e afarizmit të atyre kompanive.

Neni 18
Ndalimi i përkrahjes dhe privilegjeve të biznesit të duhanit

Asnjë institucion ose organ shtetëror nuk duhet t'i ofrojë përkrahje ose privilegje ndonjë personi apo kompanie për shitjen me shumicë ose pakicë, importin e duhanit, apo ndonjë përkrahje dhe privilegj lidhur me ndonjë fazë të importit apo shitjes së produkteve të duhanit

KREU IX
MBIKËQYRJA DHE EKZEKUTIMI

Neni 19
Organet e mbikëqyrjes dhe ekzekutimit

1. Zbatimin e këtij ligji e kryejnë inspektorët qendror e komunal dhe organet e tjera, në bazë të kompetencës së përcaktuar edhe me ligje përkatëse si:
 - 1.1. Inspektor sanitarë;
 - 1.2. Inspektor shëndetësorë;
 - 1.3. Inspektor të tregut;

- 1.4. Inspektor të punës;
 - 1.5. Inspektor të arsimit;
 - 1.6. Inspektor të transportit;
 - 1.7. Agjencioni kundër korrupsionit;
 - 1.8. Policia e Kosovës.
2. Inspektori sanitar kryen mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së neneve: 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, nenin 10 paragrafët 4. dhe 5., neni 11 , nenin 12, neni 13 paragrafin 4.1 të këtij ligji.
 3. Inspektori shëndetësor zbaton nenin 9 paragrafët 1.1., dhe neni 11 paragrafi 3.2 të këtij ligji.
 4. Inspektori i tregut zbaton nenin 3 paragrafin 3.2, nenin 9 ,nenin 10 paragrafët 10.1 dhe 10.5 të këtij ligji.
 5. Inspektori i punës zbaton nenin 10 paragrafin 3, nenin 11 paragrafët 1.2 dhe 3.2 të këtij ligji.
 6. Inspektori i arsimit zbaton nenin 9 paragrafi 1.2, nenin 11 paragrafët 3.1 dhe 3.3 të këtij ligji.
 7. Inspektori i transportit zbaton nenin 11, paragrafin 1.3 të këtij ligji.
 8. Agjencioni kundër Korrupsionit zbaton nenet 14, 15, 16, 17, 18. të këtij ligji
 9. Policia e Kosovës zbaton nenin 11 paragrafin 1.3, paragrafin 2, dhe paragrafin 3.4. të këtij ligji, si dhe të asistoj inspektoratin sanitar në mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji .
 10. Zbatimin e paragrafit 7 të këtij neni, Policia e Kosovës e kryen në pajtueshmëri me procedurat e përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë veprimtarinë e Policisë.

Neni 20 Ekzekutimi

1. Ekzekutimi i gjobave mandatore të organeve mbikëqyrëse nga neni 19, kryhet në bazë të akteve juridike që e rregullojnë punën, veprimtarinë dhe organizimin e tyre.
2. Kërkesën për hapjen e procedurës për kundërvajtje, e paraparë sipas këtij ligji e bëjnë organet mbikëqyrëse.
3. Me kërkesë të organeve kompetente për mbikëqyrje dhe zbatimin e ekzekutimit, Policia e Kosovës ka për detyrë, që t'u japë mbështetje këtyre organeve.

KREU X GJOBAT MANDATORE DHE DENIMET

Neni 21

1. Për shkeljet e mëposhtme personi dënohet me gjobë, siç vijon:
 - 1.1. prodhuesi apo importuesi që shkel dispozitat e nenit 3, dhe 4 të këtij ligji, dënohet për

kundërvajtje, me gjobë njëzetmijë (20.000) euro;

1.2. prodhuesi apo importuesi që shkel dispozitat e nenit 5 të këtij ligji, dënohet me gjobë për kundërvajtje shtatëmijë (7.000) euro;

1.3. prodhuesi, importuesi, ose shitësi me shumicë që shkel dispozitat e nenit 6 dhe 7 të këtij ligji dënohet me gjobë për kundërvajtje njëzetmijë (20.000) euro

1.4. shitësi me pakicë që shet ose ofron për shitje produkte të duhanit në kundërshtim me nenin 3 paragrafit 2. të këtij ligji, dënohet me gjobë për kundërvajtje njëmijë (1.000) euro.

1.5. shitësi me pakicë që shet ose ofron për shitje produkte të duhanit në kundërshtim me nenin 6 dhe 7 të këtij ligji dënohet me gjobë për kundërvajtje njëmijë (1.000) euro.

2. Për shkeljet e mëposhtme personi dënohet me gjobë, siç vijon:

2.1. prodhuesi, shitësi i duhanit, ose agjentët e tyre, shoqatat, ose entitetet tjera që veprojnë në emër të tyre, ose ndonjë personi përgjegjës për iniciimin e reklamave, promovimeve, ose sponsorimeve të duhanit të përcaktuara me nenin 8 të këtij ligji, dënohet me gjobë për kundërvajtje njëzetmijë (20.000) euro;

2.2. entitetet që prodhojnë ose publikojnë përmbajtje reklamuese, promovuese, ose sponsoruese të përcaktuara me nenin 8 të këtij ligji, dënohen me gjobë për kundërvajtje shtatëmijë (7.000) euro;

2.3. entiteti që shpërndan përmbajtje reklamuese, promovuese, ose sponsoruese të ndaluara me nenin 8 të këtij ligji, kur logjikisht do të duhet të kishte qenë i vetëdijshëm për materialin e ndaluar dhe kur ka qenë në pozitë për të hequr materialin apo pamundësuar qasjen në të, por nuk e ka bërë këtë, dënohet me gjobë për kundërvajtje dhjetëmijë (10.000) euro;

2.4. mediumi ose organizuesi i ndonjë ngjarjeje si dhe pjesëmarrësit e tjerë që marrin pjesë në reklamim, promovim, ose sponsorim të duhanit të përcaktuar me nenin 8 të këtij ligji, dënohet me gjobë për kundërvajtje dhjetëmijë (10.000) euro

2.5. personi fizik që shkel nenin 8, dënohet me gjobë për kundërvajtje njëmijë (1000) euro

3. Për shkeljet e mëposhtme, personi dënohet me gjobë, siç vijon:

3.1. personi juridik-subjekti afarist që shkel nenin 9, paragrafi 1., 2., 3. dhe 4. të këtij ligji, dënohet me gjobë për kundërvajtje tremijë (3.000) euro;

3.2. personi fizik që shkel nenin 9, paragrafi 1., 2., 3. dhe 4. të këtij ligji, dënohet me gjobë për kundërvajtje pesqind (500);

3.3. personi juridik-subjekti afarist që shkel nenin 9, paragrafi 5. dhe 6. të këtij ligji, dënohet me gjobë për kundërvajtje dymijë (2.000) euro;

3.4. personi fizik që shkel nenin 9, paragrafi 5. dhe 6., dënohet me gjobë mandatore dyqind (200);

3.5. personi juridik-subjekti afarist që shkel nenin 10, paragrafi 1., 2., 3., 4. dhe 5. dënohet me gjobë për kundërvajtje dymijë (2.000) euro;

3.6. personi fizik që shkel nenin 10, paragrafi 1., 2. dhe 3., 4. dhe 5. dënohet me gjobë mandatore dyqind (200);

4. Për shkeljet e mëposhtme personi fizik dhe juridik dënohet me gjobë, siç vijon:

4.1. personi juridik-subjekti afarist që shkel dispozitat e nenit 11 të këtij ligji, dënohet me gjobë për kundërvajtje tremijë (3.000) euro;

4.2. personi fizik që shkel dispozitat e nenit 11 të këtij ligji, dënohet me gjobë mandatore pesëdhjetë (50) euro;

4.3. personi përgjegjës që shkel dispozitat e nenit 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë për kundërvajtje pesqind (500) euro;

4.4. personi përgjegjës që shkel dispozitat e nenit 13 paragrafi 4.1. të këtij ligji dënohet me gjobë për kundërvajtje pesmijë (5.000) euro.

KREU XI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 22 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen Ligji për duhanin Nr.02/L-36 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin Nr.03/L-157.

Neni 23

1. Prodhuesit dhe importuesit e prodhimeve të duhanit janë të obliguar që në afat prej dymbëdhjetë (12) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të vendosin shenjëzimet në paketimet e prodhimeve të duhanit të përcaktuara sipas nenit 6 paragrafi 5. dhe 6. të këtij ligji.

2. Prodhuesit dhe importuesit e prodhimeve të duhanit janë të obliguar që në afat prej tridhjetë e gjashtë (36) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të vendosin shenjëzimet në paketimet e prodhimeve të duhanit të përcaktuara sipas nenit 6 paragrafi 7. të këtij ligji.

3. Institucionet, organizatat e të gjitha llojeve si dhe mjetet e transportit publik, janë të obliguara që në afat prej katër (4) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të vendosin shenjat e ndalesës së pirjes së duhanit.

Neni 24 Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-156
04 prill 2013**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-017-2013, datë 24.04.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.**